

NGA MBRËMJA E XHAZIT TË NJË ARTISTEJE TË MADHE SHQIPTARE NË MOODS TË CYRIHUT

ARTISTJA ELINA DUNI SHKËLQEU NË CYRIH ME ZË TË MREKULLUESHËM DHE MESAZHE PËR SHQIPTARËT E KOSOVËN

Kjo këngëtare e shquar xhazi me prejardhje nga Shqipëria, që sapo ka diplomuar shkollën e lartë të artit në Bernë, ku edhe jeton (që me zërin e saj po zë gjithnjë e më shumë vend në skenën evropiane të xhazit), la mbresa të pashlyeshme tek publiku (kryesisht zviceranë), jo vetëm me interpretim të mrekullueshëm të këngëve shqipe e në gjuhët e tjera, por edhe me përshëndetjen e saj në mes të programit, kur tha se: "Do të këndojë për shtetin më të freskët në botë- Kosovën!"

Cyrih, 21 shtator

Publiku ardashës i Cyrihut i cili mori pjesë në koncertin e xhazit të kuartetit të artistes së re madhe shqiptare me banim në Zvicër, pati rastin që të enjten e kaluar të përjetojë çaste të jashtëzakonshme me një program të një niveli të lartë artistik, interpretuar nga këngëtarja e xhazit me prejardhje nga Shqipëria, Elina Duni, e cila që nga dalja në skenë (me një fustan të zi dhe këmbë të zbatuara) deri në fund të programit ishte një yll i vërtetë që shkëlqeu në ambientin karakteristik Moods të Cyrihut. Përndryshe Elina Duni, me kuartetin e saj të xhazit dhe me zërin e saj të mrekullueshëm po zë gjithnjë e më shumë vend në skenën evropiane të xhazit, duke pushtuar klubet e xhazit në disa shtete si në Slllovakia, Francë, Belgjikë, Gjermani etj.

Një artiste e madhe shqiptare që po i pushton skenat e Evropës

Por, ti kthehemi mbrëmjes në Cyrih, atë që e bëri të veçantë këtë artistet madhe, e cila po i pushton skenat në shumë metropole të Evropës. Për dallim nga shumë kolegë e kolege shqiptare, që në hapje të programit ajo nuk e fshehu identitetin e saj kombëtar, përkundrazi atë "shtriu" për gjatë tërë programit duke përshëndetur: që në fillim duke përshëndetur shqip (pos në gjermanisht) dhe duke thënë se vejnë nga Shqipëria, ku edhe ka kaluar fëmijërinë. Por pikën kulmuese e arriti kur tha do të këndonte një

këngë shqip në shenjë të shtetit më të ri në botë, "shtetit më të freskët Kosovës!", siç tha ajo. Dhe këtë gjest e bëri pikërisht në momentin kur me një këngë e kishte pushtuar publikun, ndaj edhe kjo bëri aq përshtypje jo vetëm tek publiku i pakt shqiptar, por edhe tek ai zviceran i cili fjalën për shtetin e ri të Kosovës e priti me duartrokitje e ovacione.

Edhe vet raportuari që prezantoi Elina Duna, ishte më se i përzgjedhur dhe i pasonte edhe për nga meloditë por edhe për nga përmbajtja e gjuhëve të ndryshme një yllberi, apo mozaiku të vërtetë shumëngjyrësh. Ndonëse këngët shqipe që i këndoi me aq afsh përbënin pjesën më të madhe të programit, ajo kësaj mbrëmje me kuartetin e saj prezantua edhe me këngë në gjuhën frëngjishte, greqishte e bullgarishte, duke dhënë paraprakisht shpjegime të shkurta edhe për gjenezën e tyre.

Një oktet i shkëlqyeshëm me emrin "Elina Duni"

Nuk ishin vetëm niveli i lartë artistik i interpretimit dhe orkestra e shkëlqyeshme që e shoqëronte atë e përbërë nga Colin Vallon, Bänz Oester dhe Norbert Pfammatter, që ia ritmin madhështinë kësaj mbrëmje të shkëlqyeshme xhazi, por edhe vetë paraqitja e jashtme tejet modeste e artistes sonë të madhe Elina Duni, e cila pas disa programeve të njëpasnjëshme në Lozanë, Lucern e Bernë, ku më 9 shtator me legjendën shqiptare "Konstatini dhe Doruntina" kishte mbrojtur temën e diplomës në Shkollën e Lartë të Artit në Bernë.

Për ne që nuk kishim pas rastin të shohim programe të kësaj natyre, me muzikë xhazi, kjo mbrëmje ishte më se mbresëlënëse. Ndaj edhe këngët shqipe që dëgjuam në interpretim të saj siç ishin ato "As e vogël as e madhe", "Qaj zemër mos pusho", e sidomos "Baresha", lanë aq përshtypje magjepse, sa na dukej se ndodheshim diku ambientet e mrekullueshme të tokave shqiptare.

Dhe gjithsesi mesazhi për atdheun dhe bukurit e tij joshëse ishte dhe është, siç na deklaroi në fund të koncertit edhe vet artistja, një mesazh që e përcjell kudo edhe pse në moshën 11-vjeçare u largua nga vendlindja. Pra, Elina Duni paraqet një ambasadore të vërtetë të kulturës shqiptare kudo që arrin, madje jo vetëm shqiptare por edhe ballkanase, sepse ajo me një mënyrë synon që atë pjesë të Evropës Juglindore ta inkorporojë në kulturën e përgjithshme evropiane. Sepse siç pohon vet Elina Duni përmes këngës ka gjetur mënyrën se si ta kapërcej greminën midis atdheut dhe mërgimit.



Elina Duni, në Moods të Cyrihut, mahniti jo vetëm me interpretim të lartë artistik, por edhe me mesazhet për shqiptarët e Kosovën



Kuarteti i shkëlqyeshëm, "Elina Duni" me muzikantët e shkëlqyeshëm Colin Vallon, Bänz Oester dhe Norbert Pfammatter

DREJT ZENITIT ARTISTIK

Elina Dunin, po i ngjitet vazhdimisht shkallëve të sukseseve në skenat muzikore, duke përfshi edhe disa festivale. Kështu vjet në festivalin e Lozanës "jazz onze plus", ku pat deklaruar se: "Xhazi për mua ishte Zvicra, ndërsa Shqipëria ishte fëmijëria ime...", për shkak të zërit të saj të formuar u quajt "surpriza më e bukur muzikore e shekullit të 21-të në Zvicër; ndërsa që me shumë sukses u prezantua edhe në Festivalin e xhazit në Eberswalde, pranë Berlinit.

Në një vlerësim të një kritike shqiptare thuhet se "Në procesin e përpunimit Elina Duni kujdeset që këngët të mos e humbin thelbin fillestar dhe t'u qëndrojnë sa më larg stereotipave". Elina është edhe një njohëse e mirë e gjuhëve: flet rrjedhshëm pesë gjuhë evropiane dhe nuk preferon ta ndajë muzikën shqiptare nga ajo ballkanike. Në CD-në "Baresha" ajo bën një turne akustik nëpër "rëpirat e ballkanit", përveç këngëve shqiptare, si "Qiparisi", "Baresha", "Lulje", ajo këndon edhe këngë greke, bullgare.

E vetmja mangësi- një publik më i madh shqiptar

E vetmja mungesë e kësaj mbrëmje reprezentative të xhazit, ishte mungesa e një publiku më të madh shqiptar, ndoshta edhe nga

fakti se Elina Duni ende njihet pak në këtë pjesë të Zvicrës nga vetë shqiptarët. Por në të ardhshmen do të ishte me interes që ajo të jetë edhe ma shumë në mesin e publikut shqiptar, i cili ka çka të dëgjojë prej

RRUGËTIMI JETËSOR I ELINËS

Elina Duni, u lind vitin 1991 në Shqipëri në një familje ajo kontaktin e parë me muzikën e mori qysh në Tiranë ku që në moshën pesëvjeçare, ku do të këndonte nëpër festivalet për fëmijë dhe do të mësonte pianon. Në rrugëtimin e saj të suksesshëm që në fëmijëri i ndihmoi prejardhja artistike e prindërve, e ëma Besa Myftiu, shkrimtare dhe dramaturge dhe i ati Spiro Duni, regjisor teatri, si dhe vetë Shqipëria e viteve 80-të, bënë që fëmijëria në kujtimet e Elinës të jetë një nga epokat më të bukura të jetës së saj. Me të migruar në Zvicër me të amën në vitin 1992, ajo vazhdon shkollimin e mesëm e të lartë, sa që nga viti në viti 2004 të vazhdojë Shkollën e Lartë të Artit në Bernë dhe tash edhe ta përfundojë atë

kësaj artiste të madhe e cila një ditë do të pushtojë edhe skenat e tjera jo vetëm në Evropë por edhe jashtë saj, sepse vetë niveli i saj artistik dhe orkestra e shkëlqyeshme që mban emrin e saj janë parakusht për këtë pohim tonin. Pas disa koncerteve të suksesshme në Zvicër, Elina Duni, vjeshtën e sivjetme muzikore në nëntor do ta vazhdojë edhe në disa lokalitetet të Gjermanisë, ndërsa që me gazetarë shqiptarë nuk e fshihni dëshirën e saj të madhe që me disa koncerte të shkojë edhe në Kosovë, ku thotë se muzika e xhazit njihet dhe adhurohet më shumë se në Shqipëri. / Rexhep Rifati